



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-127277

Dt. 04.10.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesë së **Zani Herceg** nga **Prizreni** me banim në rrugën **”Edit Durham” nr.10**.-Prizren, sipas bazës të nenit 3 alinea 1 pika 7 e lidhur me nenin 17 dhe 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-212 dt. 31.07.2013, si dhe nenit 3 alinea 1 pika 1.1, 1.4, 1.7, 1.10, 1.17, 1.20, 1.21 dhe të nenit 5 alinea 1 pika 1.1 si dhe nenit 14 alinea 1 pika 1.1 dhe në lidhje me nenin 15 alinea 1 pika 1.2 dhe nenit 19 alinea 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe dhe dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksë, tarifë, ngarkesë dhe gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.01/011-46063 dt.28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27 dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 me Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Zani Herceg		
Adresa:	”Edit Durham” nr.10		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti – banim individual		
Emri i projektuesit	Biro projektuese – N.P.N “D-Project”-Shemsi Daka B.I.		
Adresa:	”Komuna e Parist “Llamella 3 Hyrja 1banesa, nr.2-Prizren		
Telefoni:	044//	Emaili:	npn.dproject1@gmail.com

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore së **Zani Herceg** nga **Prizreni** me banim në rrugën **”Edit Durham” nr.10**. me etazhitet **P+1** me numer ngastres **P-71813023-00148-7 Z.K.Dushanove**.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren-“Edit Durham”nr.10.	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në ë Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar Zone banimi</p> <p>Objekti – banim individual do të ndërtohet në parcelën P-71813023-00148-7 Z.K.Dushanove me sip. sip. 608m² sipas kopjes se planit Etazhiteti i objektit do të jetë P+1</p> <p>Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=81.60m².</p> <p>Sipërfaqja bruto e katit I është S=86.70m²</p> <p>Sipërfaqja neto e përdhësës është S=66.80m².</p> <p>Sipërfaqja neto e katit I është S=71.20m²</p> <p>Siperfaqja bruto e objektit eshte S=168.30m²(sipas lejes)</p> <p>Siperfaqja neto e objektit eshte S=138.0m²(sipas lejes).</p> <p>Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 944.05 €.</p> <p>Vlera e objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 106,024.10€</p>	GPS Koordinatat://

Lloji i ndërtimit të propozuar:	Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindertim <input type="checkbox"/>	Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndertimeve te propozuera:	Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II <input type="checkbox"/>	
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit?	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
Perdorimi i propozuar:objektit-	banim individual		

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Zani Herceg** nga **Prizreni** me banim në rrugën **”Edit Durham” nr.10**.me etazhitet **P+1** me numer ngastres **P-71813023-00148-7 Z.K.Dushanove**.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriat i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Zani Herceg** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin – banim individual**.
Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit 04-353/01-34289, Dt.04.07.2024
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Pëlqimi nga KRU ”Dukagjini-Radoniqi” SH.A.Gjakove
- Vertetim nga sektori i menaxhimit të mbeturinave nga DSHP.
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike – për Kategorinë e I

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-127277

Bashkëpunetor profesional:

Zana Belloda inxh.dip.ark.

DREJTORI:

Pranverim Berisha,jur.